

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 7469/17
MR-INTERNACIONAL SHPK
kundër Shqipërisë
(shih tabelën bashkangjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 9 dhjetor 2021, si Komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, *kryetar,*

Peeter Roosma,

Andreas Zünd, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

Pasi mori në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 16 janar 2017,

Pasi mori në konsideratë deklaratën e parashtruar nga Qeveria e paditur, me anë të së cilës i kërkohej Gjykatës të hiqte kërkesën nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e kompanisë kërkuese ndaj kësaj deklaratë,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë.

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kompanisë kërkuese janë paraqitur në tabelën bashkangjitur. Kompania kërkuese u përfaqësua nga z. F. Caka, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

Ankesat e kompanisë kërkuese, në lidhje me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme iu komunikuan qeverisë shqiptare (Qeveria), sipas nenit 6§1 të Konventës. Ankesat, mbështetur në të njëjta fakte, u komunikuan edhe në mbështetje të parashikimeve të tjera të Konventës.

Pas negociatave të pasuksesshme për një zgjidhje miqësore, më 30 shtator 2021, Qeveria parashtrroi një deklaratë mbi një zgjidhje të problemeve që lindin nga këto ankesa. Qeveria pranoi moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme. Gjithashtu, Qeveria pranoi se autoritetet e brendshme kishin shkelur të drejtat e kompanisë kërkuese të garantuara nga parashikime të tjera të Konventës. Qeveria ofroi t'i paguante kompanisë kërkuese shumën e detajuar në tabelën bashkangjitur dhe e ftonte Gjykatën ta hiqte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1(c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën e shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes dhe do të duhej të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mospagimit të kësaj shume brenda periudhës së sipërpërmendur prej tre muajsh, Qeveria ndërmerre të paguante interesin e thjeshtë për këtë shumë, nga përfundimi i periudhës për shlyerjen e shumës deri në shlyerjen e saj, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë përqindjeje. Pagesa përbën edhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Për këtë arsye, Qeveria i kërkoj Gjykatës që ta hiqte kërkesën nga lista e çështjeve.

Më 23 tetor 2021, kompania kërkuese informoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës së Qeverisë.

LIGJI

Gjykata konstaton se, në mbështetje të dakordësimit të qartë të kompanisë kërkuese me kushtet e deklaratës së bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si një zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen e arritur midis palëve. Gjykata është e bindur se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar vijimin e shqyrtimit të kërkesës.

Për sa më sipër, është e drejtë që çështja të hiqet nga lista e çështjeve.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos, ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 13 janar 2022.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSREGJISTRARE
E PËRKOHSHME

Dmitry Dedov
KRYETAR

SHTOJCË
KËRKESË ME ANË TË SË CILËS PARASHTROHET ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS
(MOSZBATIM OSE ZBATIM I VONUAR I VENDIMEVE TË BRENDSHME)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i regjistrimit	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Ankesa të tjera në mbështetje të praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së dakordësimit të kërkesit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot dhe shpenzimet për kërkes (në euro) ¹
7469/17 16.1.2017	MR- INTERNACIONAL SHPK 1999	Caka Ferdinand TIRANA	Neni 13 – mungesa e mjeteve efikase në ligjin e brendshëm për moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve të brendshme Prot. 1, neni 1 – ndërhyrje në gëzimin e paqte të pronës, për shkak të zbatimit të vonuar të vendimeve të formës së prerë	30.9.2021	3.11.2021	2.750

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkesit.